



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1172 Prot.

Tiranë, më 29 2019

**VENDIM Nr. 204, datë 29.08.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 48, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 10, datë 29.08.2019, pasi shqyrtoi Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit *"Hotel 3-4 kat (Rikonstruksion +shtesë kati dhe shtesë anësore në objekt ekzistues 1 kat) rruga "Glaukia", zonë arkeologjike "B" Durrës-subjekti Z. Bashkim Stafhasani, paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi,*

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit *"Hotel 3-4 kat (Rikonstruksion +shtesë kati dhe shtesë anësore në objekt ekzistues 1 kat) rruga "Glaukia", zonë arkeologjike "B" Durrës-subjekti Z. Bashkim Stafhasani, paraqitur nga subjekti i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi.*
2. Subjekti Z. Bashkim Stafhasani, të vijojë procedurën e shqyrtimit dhe vendimarrjes në organet përkatëse të qeverisjes vendore.
3. Pas paisjes me lejen përkatëse të lëshuar nga organet e qeverisjes vendore, punimet e gërmimit do të realizohet nën monitorimin ditor të subjektit të licencuar në arkeologji, në vijim të akt-marrëveshjes tre palëshe të lidhur më parë për këtë objekt.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
ELVA MARGARITI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

Adresë: Kruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)